



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

Për:	Ertan Munoglu – Menaxher i Programit
Nga:	Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume
Kopje:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv
Data :	03 maj 2011
Subjekti :	Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me datën 03 maj mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë z. Xhafer Dema – Kryesues, z. Bashkim Hyseni – zv. Kryesues dhe anëtarët z. Shaqir Demiri dhe z. Fitim Mëziu, znj. Qamile Ramadani- menaxhere nga DFID. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK.

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektivave, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

PËRMBLEDHJE:

Mbledhjen e hapi z. Xhafer Dema me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunitat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Më pas z. Dema dha fjalën menaxherës nga DFID znj. Qamile Ramadani për prezantimin dhe njoftimin e anëtarëve për programin e ri me qëllim fuqizimin e sistemit të menaxhimit për decentralizimin financiar dhe administrativ të shërbimeve të kujdesit social.

Në fjalën e saj znj. Ramadani sqaroi qëllimin e programit të DFID-it në përfordimin e sistemit financiar dhe administrativ për decentralizimin e shërbimeve sociale. Ky program do të mbështes zhvillimin e kapaciteteve të Kolegjiut për të koordinuar dhe lehtësuar dialogun politik në lidhje me shërbimet sociale për njerëzit në nevojë. Përfitues të këtij projekti do të jenë MPMS, MAPL, MEF, AKK me Kolegjiut. Në nivel lokal përfitues janë Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoritë për Buxhet dhe Financa dhe Qendrat për Punë Sociale.

Rezultati pritet të jetë kapaciteti i zhvilluar i Qeverisë së Kosovës për të planifikuar dhe menaxhuar shpenzimet publike për shërbime të kujdesit social, në kuadër të planeve të qarta të shpenzimeve, duke u bazuar në një analizë të nevojave për shërbimet e kujdesit social.

Lidhur më këtë pikë pati diskutime nga paneli dhe u vendos që të formohen dy grupe në kuadër të Kolegjiut, grupi i parë të jetë përgjegjës për fushën e shëndetësisë ku do të drejtohet nga kryesuesi i kolegjiut z. Xhafer Dema si dhe grupi i dytë të jetë përgjegjës për fushën e mirëqenies sociale dhe të drejtohet nga zv. kryesuesi z. Bashkim Hyseni, ku edhe të ketë një koordinim të mirë në mes të dy grupeve. Poashtu u vendos që në Kolegjiut të përfshihen edhe Drejtoritë e Mirëqenies Sociale nga Komunitat e Mitrovicës dhe Prizrenit, meqë këto dy Komunitat kanë themeluar Drejtoritë të veçanta për këto fusha.

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës të Kolegjiut për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në vitin 2011.

- **Fusha e Mirëqenies Sociale** duke pasur për objektive përfordimin e funksionalitetit të kolegjiut në aspektin e shërbimeve. Poashtu u vendos që një plan më detaj për shërbime sociale të përgatitet në bashkëpunim me DFID-in.
- **Shërbimet Shëndetësore Komunale** duke pasur për objektive avancimin dhe kompletimin e infrastrukturës ligjore si dhe decentralizimin dhe zbatimin e kompetencave në fushën e shëndetësisë.

Takimi kishte për objektiv edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiumit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Takimi i radhës

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të mbahet të premten me datën 27.05.2011 në Mitrovicë.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Ri-organizimi i Kolegjiumit
2. Prezantim i projektit të DFID-it për mirëqenie sociale
3. Plani i Punës për Shërbime sociale me përkrahje të DFID-it
4. Pjesëmarrje në Grupet Punuese qeveritare për Ligjet relevante
5. Rekomandim për decentralizimin e shërbimeve sekondare shëndetësore
6. Punësimi i mjekëve të ri

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.